



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**Në çështjen juridike :**

**AC-I-15-0083**

***Ankuesi / E paditura***

**A0001 Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Agim Ramadani 23, Prishtinë.**

**Kundër:**

***Ankuesi në shkallë të parë***

**D.S., Parteš.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Hajrie Shala dhe Sabri Halili, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditurës , të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së, SCEL-11-0065-C0091 të datës 21 Prill 2015, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12/09/2019, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**1.** Ankesa e AKP-së aprovohet pjesërisht.

2. Vërtetohet, pika-I- e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS, SCEL-11-0065-C0091 të datës 21 prill 2015.
3. Anulohet, pika -II- e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS, SCEL-11-0065-C0091, të datës 21 prill 2015.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike**

NSH "I" në Gjilan, është privatizuar më 02.03.2006.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar në mjetet e informimit publik në gjuhën Shqipe me datë 11 dhe 12 nëntor 2011, si dhe në gjuhën Serbe me datë 10 dhe 11, dhe në tirazhin e fundjavës me 12 dhe 13 nëntor 2011.

Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS kundër listës përfundimtare të punëtorëve ishte 03 dhjetor 2011.

Më 21 Prill 2015 Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin SCEL-11-0065-C0091, me të cilin:

- I- Ankesa e C0091 D.S. është aprovuar si e bazuar .
- II- e paditura është përgjegjëse për shpenzimet e procedurës.

Ndaj këtij Aktgjykimi të Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i DHPGJS-së SCEL-11-0065-C0091, është paraqitur 01 ankesë, nga ankuesi, A0001 Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Me datë 13.05.2015 Ankuesi A0001 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL-11-0065-C0091, të datës 21 Prill 2015, për

shkak të siç thuhet, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe i propozon Kolegjit të Apelit i Dhomës së Posaçme ta aprovojë ankesën si të bazuar, dhe anulon në tërësi Aktgjykimin e shkallës së parë: SCEL-11-0065-C0091, të datës 21 Prill 2015. Ajo ankesën e ankuesit në shkallë të parë e pohon si të pa bazuar pa asnjë fakt relevant në bazë të cilit do të ishte vërtetuar diskriminimi dhe pa ofruar nga ankuesi fakte dhe prova nga të cilat mund të parashikohet diskriminimi direkt apo indirekt në pajtim me nenin 8.1 i ligjit kundër diskriminimit.

Në rast se paditësi nuk paraqet fakte relevante në lidhje me diskriminimin, edhe e paditura nuk mund të paraqes kundër argumentet në lidhje me diskriminimin. Një parim të tillë e shpreh edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tutje GJEDNJ) sikur në rastin vendimin "Angelova vs. Bulgaria" të datës 16/06/2002.

AKP-ja thekson se sa i përket shpjegimit në pikën 2, në lidhje me pagesën e shpenzimeve të procedurës në shumën prej 50 euro, është i pabazuar.

AKP-ja kundërshton edhe pikën –II- të dispozitivit të Aktgjyimit të ankimuar me të cilin AKP-ja ngarkohet me shpenzimet procedurale me arsyetim se praktika e DHPGJS-s ishte e tillë që në mungesë të një plani të miratuar nga KGJK-ja palët nuk ngarkohen me shpenzimet gjyqësore. Andaj kërkon nga Kolegji i Apelit ndryshimin e pikës –II- dhe lirim nga pagesa e taksës gjyqësore në shumë prej 50 euro.

Lista përfundimtare e punëtorëve të NSH "I", është publikuar në nëntor të vitit 2011 që do të thotë se kjo lëndë është që nga viti 2011.

Andaj si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe arbitrar të gjendjes faktike, pason edhe aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, respektivisht deri te aplikimi i të drejtave të cilat nuk i takojnë ankuesve, e në të cilat bazohet arsyetimi i aktgjyimit të atakuar.

Më datë 04.05.2018, ankesën e ka pranuar D.S., dhe ndaj të njëjtës nuk ka parashtruar përgjigje.

## **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankueses është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ,Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

## **Ankesa e të paditurës AKP-së A0001 dhe Vlerësimet e Kolegjit të Apelit.**

E paditura e konteston Aktgjykimin e ankimuar, për ankuesin, ankesa e të cilit është aprovuar si e bazuar dhe ky ankues është përfshirë në listën përfundimtare për të drejtën legjitime për 20 %.

E paditura me ankesë e kundërshton aktgjykimin e ankimuar, pretendon se ankuesi nuk ka ofruar fakte relevante në bazë të të cilave do të vërtetohet fakti i trajtimit jo të njëjtë ose për zbatimin e diskriminimit direkt dhe indirekt në përputhje me nenin 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit. Në këto rrethana e paditura pretendon se nuk ka mundur të ofroi kundër argumentet e veta në lidhje me diskriminimin, si pasojë e konstatimit të gabuar të gjendjes faktike ka ardhur edhe tek zbatimi i gabuar i së drejtës materiale.

Qasja që i bënë Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i DHPGJS-së, çështjes së interpretimit të diskriminimit që ka ndodhur lidhur me ankuesin është e saktë dhe e bazuar në ligj dhe një qasje e tillë e interpretimit të diskriminimit, pranohet edhe nga Kolegji i Apelit.

Në mënyrë që të ndalojë diskriminimin, promovoj dhe të fusë në fuqi parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, më 30 korrik 2004, miratoi Ligjin Kundër Diskriminimit nr. 2004/3.

Sa i përket barrës së provave, neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, mbi barrën e provave, thotë si vijon:

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas interpretimit të mësipërm, kur një ankues ka për qëllim të dëshmojë se është diskriminuar, nga ai/ajo kërkohet vetëm që të pretendojë faktet specifike nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë), dhe i mbetet të paditurit (në këtë rast Agjencisë) që të dëshmojë të kundërtën, d.m.th. të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas të drejtës precedentele DHPGJS-së(ASC-11-0069, AC-I-12-0012 etj), të diskriminuar mund të llogariten:

- a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, apo që u takojnë minoriteteve ashkali, romë, egjiptian, goran dhe turq, të cilit ishin larguar për arsye diskriminimi në periudhën e ashtuquajtur të "masave të përkohshme serbe" (që sillen prej vitit 1989 deri në vitin 1999), apo të cilët u diskriminuan edhe në periudha të ndryshme, për shkak të etnisë së tyre, besimeve politike dhe religjioze, etj.;
- b) punëtorët e përkatësisë etnike serbe të cilët për shkak të mungesës së sigurisë pas vitit 1999, nuk u paraqiten në punë dhe të njëjtit nuk u gjendën në listat përfundimtare të punëtorëve.

Me dt. 05.12.2011, ankuesi në shkallë të parë C0091 D.S. , i lindur me 31.08.1949 ka paraqitur ankesë pranë DHPGJS kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ka kërkuar përfshirjen e tij në listën e punëtorëve me të drejta legjitime në 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH I" në Gjilan.

Ankuesi ka pohuar se ka punuar në I" në Gjilan deri në vitin 1999, po ashtu ka deklaruar sa ka qenë i diskriminuar për shkak se është i nacionalitetit serb.

Si provë ankuesi ka bashkangjitur: Vendimin mbi caktimin në pune dhe detyra të punës të vitit 1984 dhe 1986 Vendime të Pushimit Vjetor në periudha të ndryshme kohore, dhe një kopje të letërnjoftimit të punëtorit me nr. amzës 1159.

AKP-ja, në përgjigjen e saj ka pohuar se ankuesi nuk ka qenë në marrëdhënie pune në kohën e privatizimit, i njëjti nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, me ndryshime.

Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara ka ardhur në përfundim se ankuesi është i nacionalitetit serbë dhe ishte detyruar të largohet nga puna në vitin 1999, ndërsa e paditura nuk ka arritur me ndonjë provë të vërtetojë se nuk ishte shkelë parimi i trajtimit të barabartë të punëtorëve.

Andaj Gjyqtari, lidhur me këtë ankues ka konstatuar se i njëjti do ti kishte plotësuar kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, po të mos ishte subjekt i diskriminimit duke ia njohur të drejtën këtij ankuesi që emri i tij të futet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konkluzioni i Gjyqtarit të vetëm të Kolegjit të Specializuar se ky ankues i ka plotësuar kushtet që të përfshihet në listën përfundimtare, vendimi mbi themelimin e marrëdhënies së punës në kohë të pacaktuar dhe diskriminimit është i saktë AKP-ja as në ankesë përveç aspektit deklarativ nuk ka parashtruar prova me të cilat do të vërtetonte të kundërtën. Andaj ankesa e AKP-së duhet të refuzohet si e pabazuar, të vërtetohet pika -I- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar dhe ankuesi D.S. duhet të mbetet në listën përfundimtare.

Kolegji i Apelit sa i përket pikës -II- të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, merre qëndrim ligjor se kjo pikë duhet të prishet dhe të lirohet e paditura nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën para Kolegjit të Specializuar. Çështja është iniciuar me ankesën e D.S. ndaj listës përfundimtare me datë 30/11/2011 ,do të thotë dy vite më parë, para se të hynë në fuqi Vendimi i KGJK-së nr. 25 për

taksa gjyqësore. Është qëndrim ligjor konstant i Kolegjit të Apelit (Shih Jurisprudencën e Kolegjit të Apelit AC-I-14-0220-A0001-A0013; AC-I-14-0166; AC-I-14-0008-A0001-A0006), se për lëndët në pritje edhe në rastin e humbjes së kontestit, asnjë palë në procedurë nuk mban obligim të paguaj taksën gjyqësore para se të ketë hyrë në fuqi Vendimi i KGJK-së nr.25 i datës 5 mars 2014 për taksa gjyqësore. Ky vendim është publikuar në Web faqen e KGJK-së me datë 27 mars 2014, dhe vetëm nga dita e publikimit ai është në fuqi dhe i zbatueshëm. Andaj vendimi i gjyqtarit të vetëm të Kolegjit të Specializuar që të obligoj të paditurën që të paguaj taksën gjyqësore prej 50 euro, nuk ishte i drejtë dhe për këtë arsye prishet pika e -2- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar. Për më tepër edhe Aktgjykimi është nxjerrë në kohën kur palët në çështjet që kanë të bëjnë me lisat e punëtorëve sipas Vendimit të KGJK-së nr.25 i datës 5 mars 2014 janë të liruar nga pagesa e taksës gjyqësore.

Në bazë të këtyre arsyeve aprovohet pjesërisht ankesa e ankueses, respektivisht vërtetohet pika -I- e dispozitivit dhe anulohet pika -II- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar të gjyqtarit të vetëm të Kolegjit të Specializuar.

### **Taksat gjyqësore:**

Në pajtim me nenin 13.7 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 01/06/2015, ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 100.00 €.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, më 12/09/2012

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_

## **URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT**

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tek(përfshirë edhe përkthimin në gjuhën Serbe)

- Paditësi/ankuesi.
- Të paditurës.
- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën SCEL-11-0065-C0091.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues.